



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2024:002412

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06230477

**C.nr.39/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi**, me praktikantin R.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses K.H. me numër personal .... nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat A.Q.G. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,240.93 euro, jashtë seance, me datë 30.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses K.H. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, që paditësës në emër të kompensimit të pagës së 13, për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë, duke llogaritur në mënyrë retroaktive për vitin 2018, 2019, ta paguaj shumë: për vitin 2018 shumë prej 540.48 euro, për vitin 2019 shumë prej 700.45 euro. Gjithsej shumë në lartësi prej: 1,240.93, me kamatë ligjore prej 8 % , duke llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfuundimtare”.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja K.H. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. A.Q.G. pranë kësaj gjykate më datë 03.01.2024 ka parashtuar padi, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e pagës së 13-të , vlera e kontestit 1.240,93 euro.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se paditësja ka qenë në marrdhënie pune tek e paditura në bazë të kontratës së punës nr. 16/67 nga e cila ka krijuar marrdhënie pune nga data 12.06.2018 deri në vitin 2020, pasi që e njejta e ka ndërprerë marrdhënien e punës për shkak të specializimit. E paditura ka kërkuar që në mënyrë retroaktive, për vitet 2018, 2019, t'i kompensohet paga e 13-të në vlerën e pagës bazë.

E paditura Komuna e Prizrenit Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të së drejtave të cilat rrjedhin nga Kontratën Sektoriale e nënshkruar me 12.06.2018, mes Qeverisë së Kosovës Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës

së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës (nenet 90 par. 6) dhe kontratës individuale, nuk e ka bërë kompensimin e dy pagave bazë, ashtu si i takon sipas Ligjit të punës dhe Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë së Kosovës. Lartësia e llogaritjes së një pagës bazë për kompensimin e pagës së 13-të, mbështetet në realizimin e pagës në muajin e fundit të paditëses për vitin 2018 dhe 2019. Sipas të autorizuarit të paditëses paga mujore neto e të njëjës është 546.00 euro, ku sipas përvojës së punës i takon shuma e përgjithshme prej 1.240.93 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Gjithashtu ka theksuar se paditësja Kaltrina Hoxha për periudhën sa ka qenë në marrëdhënie pune në QKMF në Prizren. Sipas të njëjtës kërkesa e paditëses është pa bazuar pasi që bazuar në nenin 17 të KKSSH të vitit 10.06. 2018 e cila ka qenë në fuqi në periudhën kohore 10.06.2018-12.06.2021, pas këtij viti, KKSSH nuk mund të shërbejë si bazë juridike për realizimin e ndonjë të drejte të paraparë me të, sepse KKSSH është inegzistente për shkak të skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj prej tri viteve sa e ka pas afatin e vlefshmërisë. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj KKSSH në munges të mjeteve financiare Komuna e Prizrenit Drejtoria për Shëndetësi dhe QKMF në Prizren nuk ka pas mundësi financiare për kompensimin e pagës së trembëdhjetë asnjërit të punësuar, ku bënë pjesë edhe paditësja e lartëshënuar. Gjykatës i ka paraqitur provat në vijim: KKSSH e datës 10.06.2018, neni 17 par. 2; Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës 212/2013 e datës 09.10.2023 paragrafi 5 dhe 6; Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia; Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia; Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia; Mendimi Juridik 112/2023 i datës 09.10.2023 për Zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale lidhur me Kërkesën e pagës së 13-të të puntorëve shëndetësorë nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditëses është e pathemeltë.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në QKMF në Prizren, nga data 23.10.2018 deri në vitin 2020.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë kontratën e marrëdhënies së punës me numër 16/67, e lidhur mes të këtu paditëses K.H. dhe të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale KKSSH e datës 10.06.2018, neni 17 par. 2; Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës 212/2013 e datës 09.10.2023 paragrafi 5 dhe 6; Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia; Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia; Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia; Mendimi Juridik 112/2023 i datës 09.10.2023 për Zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale lidhur me Kërkesën e pagës së 13-të të puntorëve shëndetësorë nga Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet.

Në bazë të cekurave në padi dhe në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, paditësja K.H. ishte në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 23.10.2018 deri në vitin 2020. Gjykata, gjeti të bazuar prapësimin e të paditurës në mendimin Juridik të gjykatës Supreme të Kosovës 212/2023 datë 09.10.2023 paragrafi 5 dhe 6 ku ceket se KKSSH në nenin 17 par.2, e kishte

përcaktuar se “ Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 për çdo vitë kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive financiarë (buxhetore) të punëdhënësit”. Që do të thotë se punëdhënësi duhet ta provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore, dhe atëherë të punsuarit nuk e gëzojnë këtë të drejtë, të cilën pamundësi Komuna e Prizrenit Drejtoria për Shëndetësi QKMF në Prizren e ka argumentuar përmes provave: Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018 të mbetura 181,914.89, vlerë kjo që nuk është e mjaftueshme për kompenzimin e pagave të 13 ta për të gjithë të punsuarit. Totali për pagesë të pagave të 13-ta, 462 punëtorëve, e nevojshme vlera financiare prej 272.857.63 ; Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 të mbetura 117,587,01, vlerë kjo që nuk është e mjaftueshme për kompenzimin e pagave të 13 ta për të gjithë të punsuarit. Totali për pagesë të pagave të 13-ta, 469 punëtorëve, e nevojshme vlera financiare prej 274.880.47, dhe Raporti i shpenzimeve Komuna e Prizrenit Shëndetësia për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020 të mbetura -0.01 euro, vlerë kjo që nuk është e mjaftueshme për kompenzimin e pagave të 13 ta për të gjithë të punsuarit.

Mendimi juridik 112/23 i datës 09.10.2023 për Zbatimin e Kontratës Kolkтиве Sektoriale lidhur me kërkesën e pagës së 13 të të punëtorëve shëndetësorë Arsyetimi i mendimit Juridik faqe 2 paragrafi i hundert “Gjykata Supreme e Kosoës Vleron si është formuluar dispozita e cituar, çështja e kompenzimit të pagës së 13-të, për puntorët shëndetësorë, është e kushtëzuar me mundësitë financiar të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta e realizimit të pagës së 13 të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin t[ provj se nuk ka pasur mundësi buxhetore”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, pasi që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil**  
**C.nr.39/2024 të datës 30.09.2024**

**Gjyqtarja**

**Edije Sezairi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.